

Partnerët e projektit:

Qendra për Arsim e Kosovës - QAK
Kompleksi i Shkollës 'Mileniumi i Tretë'
Rruga Isa Kastrati
10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 38 244 257
E-mail: office@kec-ks.org
Web: www.kec-ks.org

Forum Civil Peace Service- forum ZFD,
Sejdi Kryeziu 16 - Pejton
10000 Prishtina, Kosovo
Phone +381 38 749 065
<http://westernbalkans.forumzfd.org/>
<http://www.dwp-balkan.org>
<http://forumzfd.de/>



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga
Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë

KOHËZGJATJA:

31.03.2017-30.09.2019

FUSHAT E PROJEKTIT:

Në tërë Kosovën

GRUPET I SYNUAR:

- > **15,000** fëmijë nga **40** shkolla fillore
- > Prindërit e tyre
- > **1,000** mësime dhënë nga **40** shkolla fillore
- > 10 OJQ të nivelit më të ulët
- > Publiku i përgjithshëm

BUXHETI: 272,450.00€




Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë

PREZANTIM I SHKURTËR I PROJEKTIT

Fëmijët në Kosovë kanë mjedise miqësore dhe pa dhunë në promovimin e të drejtave të tyre





Rreth projektit:

Nëpërmjet financimit nga BE-ja, KEC dhe ZFD në bashkëpunim me 10 OJQ, po e zbatojnë projektin "promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijëve", i cili ka për qëllim fuqizimin e komuniteteve lokale për t'i përmirësuar masat e mbrojtjes së fëmijëve nëpërmjet ngritjes së vetëdijes, ndërmjetësimit dhe zgjidhjes paqësore të konflikteve. Përmes kësaj, projekti synon që të kontribuojë në krijimin e mjedisve miqësore dhe pa dhunë për fëmijët nëpër shkollat e Kosovës përmes veprimeve të synuara të organizatave të shoqërisë civile dhe komuniteteve lokale për promovimin e të drejtave të fëmijëve.

Objektivi i përgjithshëm:

Të krijohen mjedise miqësore dhe pa dhunë për fëmijët nëpër shkollat e Kosovës përmes veprimeve të synuara të organizatave të shoqërisë civile dhe komuniteteve lokale për promovimin e të drejtave të fëmijëve.



Objektivat specifike:

Të fuqizohen komunitetet lokale për ta përmirësuar masën mbrojtjes së fëmijëve nëpër shkollat përmes ngritjes së vetëdijes, ndërmjetësimit dhe zgjidhjes paqësore të konflikteve.

Janë dy komponente të ndërlidhura:



1. Ngritja e vetëdijes
2. Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve

- 1.1. Ngritja e një platforme online për ta ngritur vetëdijen për të drejtat e fëmijëve dhe për masat për mbrojtjen e fëmijëve.
- 1.2. Përgatitja e materialeve informative për fëmijët, prindërit, mësuesin dhe publikun e gjerë.
- 1.3. Organizimi i konkursit për artikullin më të mirë në media për të drejtat e fëmijëve.
- 1.4. Organizimi i konferencës rajonale për të drejtat e fëmijëve.
- 2.1 Zgjedhja e 10 OJQ-ve lokale për të punuar me 40 shkolla rurale.
- 2.2 Realizimi i trajnimeve për të drejtat e fëmijëve dhe për ndërmjetësim nga bashkëmoshatarët për OJQ-të, fëmijët, prindërit dhe mësuesin.
- 2.3 Organizimi i udhëtimeve studimore për OJQ-të dhe përfaqësuesit e shkollave në Klubet e Bashkëmoshatarëve për Ndërmjetësim në Maqedoni dhe Shqipëri.
- 2.4 Të asistohen OJQ-të lokale për t'i përkrahur shkollat në zbatimin e politikave për mbrojtjen e fëmijëve.
- 2.5 Të mbledhen shembuj të praktikës së mirë nga shkollat e synuara dhe të publikohen.

QASJA JONË - NGRITJA E VETËDIJES: për të drejtat e fëmijëve dhe masat efektive për mbrojtjen e fëmijëve në mesin e fëmijëve, prindërve, mësuesin dhe publikut të gjerë.



KOMUNITETET E SHKOLLAVE: nga viset rurale kanë kapacitet për ta siguruar mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve me ndërmjetësim nga bashkëmoshatarët dhe zgjidhje paqësore të konflikteve.

FOKUSI I ARSIMIT: Projekti ka fokus të fortë arsimor dhe synon që të sigurojë se të gjitha kurset e trajnimit dhe punëtoritë janë praktike, të zhvillohen në konsultim të ngushtë me praktikuesit e vërtetë të profesionit dhe të validohen nga përfituesit aktual, të sigurohen mundësi më të mira për atmosferë miqësore dhe pa dhunë për fëmijë.

NDJESHMËRIA GJINORE: Aktivitetet e projektit do t'i përshtaten nevojave, perspektivave dhe përvojave të burrave dhe grave dhe do ta ekzaminonë ndikimin e diferencuar të iniciativave arsimore në marrëdhëniet shoqërore mes tyre. Ai gjithashtu do t'i shqyrtojë mundësitë për pjesëmarrjen e vajzave në arsim. Partnerët e projektit do ta sigurojnë pjesëmarrjen e barabartë gjinore në zbatimin dhe vlerësimin e projektit, duke i kushtuar vëmendje gjuhës specifike gjinore në të gjitha materialet e projektit.